

# Statistikat Afatshkurtra

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	7
5. Periudha e referencës .....	7
6. Mandati institucional.....	7
7. Konfidencialiteti .....	8
8. Politika e botimit.....	8
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	9
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	9
11. Manaxhimi i cilësisë .....	10
12. Rëndësia.....	10
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	11
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	12
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	12
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	13
17. Rishikimi i të dhënave.....	13
18. Përpunimi statistikor .....	14
19. Komente.....	15
Aneks .....	15

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Elma Çali
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ECali@instat.gov.al">ECali@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	16.03.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	16.03.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	16.03.2023
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat Afatshkurtra (SASH) paraqesin një informacion shumë të rëndësishëm mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve të zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve dhe klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), të cilat operojnë në Republikën e Shqipërisë. Ndryshoret (variablat) kryesore të kërkuar janë Shitjet neto (xhiro), Prodhimi Industrial, Prodhimi në ndërtim, Numri mesatar i të punësuarve, Fondi i pagave, Çmimet e Prodhimit, Çmimet e Importit, Kosto në Ndërtim. Të gjithë treguesit e prodhuar janë të shprehur në indekse, në ndryshim vjetor dhe në ndryshim tremujor. Ato prodhohen në periudha tremujore dhe vjetore me dhe pa përshtatje sezonale. Treguesit e prodhuar sipas sektorëve, janë si më poshtë:</p>

	<p><b>INDUSTRI</b></p> <p>Volumi i prodhimit  Shitjet neto (xhiro): gjithsej, për tregun vendas dhe atë të huaj  Çmimet e prodhimit: gjithsej, për tregun vendas dhe atë të huaj  Çmimet e importit  Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul> <p><b>NDËRTIM</b></p> <p>Volumi i ndërtimit  Volumi i ndërtimit gjithsej ndahet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtime të reja</li> <li>• Rikonstruksione</li> <li>• Punime inxhinierike</li> </ul> <p>Kushtimi në ndërtim  Kostoja e materialeve  Kostoja “shpenzime për pagë”  Shitjet neto (xhiro)  Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul> <p><b>TREGTIA ME PAKICË</b></p> <p>Shitjet neto (xhiro)  Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul> <p><b>SHËRBIME TË TJERA</b></p> <p>Shitjet neto (xhiro);  Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Nomenklatura e përdorur për Statistikat Afatshkurtra është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike, (<a href="#">NVE Rev.2</a>).</p> <p><a href="#">Klasifikimi Evropian i Produkteve</a> sipas Aktiviteteve Versioni i 2008 (NP).</p>

	<p>Ndarja e treguesve të ndërtimit në Ndërtesa të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike është bazuar në <a href="#">Klasifikimin e Ndërtimit</a> (1998) (KN).</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Statistikat Afatshkurtra mbulojnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Republikën e Shqipërisë të cilat kanë aktivitet ekonomik në:</p> <p><b>1. INDUSTRI</b></p> <p>A-Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni B tek E të klasifikimit NVE Rev.2  B – Industri Nxjerrëse mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 0509  C – Industri përpunuese mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 1033  D – Energji elektrike,gaz dhe avull mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 35  E – Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 36-39.  Ndërsa treguesit e Çmimeve të Importit mbulojnë produktet e listuara nga seksioni B tek E lidhur me <a href="#">Klasifikimin Evropian të Produkteve</a> sipas Aktiviteteve (NP).</p> <p><b>2. NDËRTIMI</b></p> <p>Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin F të klasifikimit NVE Rev.2.  F – Ndërtim mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 41-43 Ndarja e treguesve të ndërtimit sipas Ndërtesa të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike është bazuar në <a href="#">Klasifikimin e Ndërtimit</a> (1998) (KN).</p> <p><b>3. TREGTIA ME PAKICË</b></p> <p>Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin G të klasifikimit NVE Rev.2  G – Tregtia me pakicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 47.11 tek 47.78</p> <p><b>4. SHËRBIME</b></p> <p>Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni G tek N të klasifikimit NVE Rev.2  G – Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 45  G – Tregtia me shumicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 46  H – Transport dhe magazinim mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49 tek 53</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Transporti hekurudhor mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49</li> <li>• Transporti detar mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 50</li> <li>• Transporti ajror mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 51</li> <li>• Magazinimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 52</li> <li>• Aktivitete të postës dhe korrierës mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 53</li> </ul>

	<p>I – Hotele mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 55.00  Bar Restorant mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 56.00  J – Informacion dhe komunikacion mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58, 61, 62</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete publikimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58</li> <li>• Telekomunikacioni mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 61</li> <li>• Shërbime të teknologjisë së informacionit mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 62</li> </ul> <p>M – Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 71  N – Agjenci udhëtimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 79.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p><b>Prodhimi</b>  Objekti i indeksit të prodhimit është të tregojë volumin e prodhimit në intervale të rregullta, kryesisht tremujore dhe vjetore. Ky indeks tregon ecurinë e volumit të vlerës së prodhimit gjatë periudhës referuese. Indeksi i prodhimit është një matje teorike që duhet saktësuar me matje praktike. Vlera e shtuar me faktorin kosto mund të llogaritet nga shifra e afarizmit (duke përjashtuar TVSH dhe taksa të tjera të zbritshme të lidhura direkt me shifrën e afarizmit), plus prodhimi i aktiveve të qëndrueshme, plus të ardhura të tjera operative plus ose minus gjendjen në stok (ndryshimi në gjendjen e prodhimit të vet), minus blerjet e mallrara dhe shërbimeve, minus taksa të tjera në produkte të cilat janë të lidhura me shifrën e afarizmit por jo të zbritshme, plus çdo subvencion mbi mallrat e marra.</p> <p><b>Shitjet neto (xhiro)</b>  Objekti i indeksit të shitjeve neto është të tregojë zhvillimin e tregut të mallrave dhe të shërbimeve. Shitjet neto përfshijnë totalin e faturuar nga njësia e vëzhguar gjatë periudhës referuese dhe kjo korrespondon me shitjet e produkteve apo shërbimeve të shërbyera palëve të treta. Shitjet neto përfshijnë gjithashtu të gjitha ngarkesat e tjera (transporti, paketimi etj.) që i kalojnë konsumatorit, edhe pse këto ngarkesa janë të listuara apo të ndara në faturë. Shitjet neto përjashtojnë TVSH dhe taksa të tjera të ngjashme të lidhura direkt me shitjet neto si dhe të gjitha detyrimet dhe taksat mbi mallrat e faturuara nga njësia. Treguesit e shitjeve neto brenda dhe jashtë vendit kërkojnë që shitjet neto të ndahen sipas destinacionit të parë të produktit bazuar në ndryshimin e pronësisë. Destinacioni është vendosur nga vendodhja e palës së tretë të cilët kanë blerë mallra dhe shërbime. Treguesi mbi indeksin e shitjeve neto vendase dhe atë për eksport vetëm mblidhen por nuk publikohen.</p> <p><b>Volumi i shitjeve neto</b>  Volumi i shitjeve paraqet vlerën e shitjeve deflatuar me çmime konstante apo dhe me çmime aktuale përmes aplikimit të deflatorëve të shitjeve.</p> <p><b>Indeksi i çmimeve të prodhimit</b>  Indeksi i çmimeve të prodhimit mat ndryshimin në nivel prodhuesi të çmimeve të produkteve të prodhuara në vend me destinacion tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> <p>Indeksi i çmimeve të prodhimit për produktet e shitura në tregun vendas mat ndryshimet e çmimeve të produkteve të prodhuara dhe të shitura brënda vendit në një periudhë të dhënë kohe (tremujore).</p>

Indeksi i çmimeve të eksportit mat ndryshimin e çmimeve të prodhimit për produktet e prodhuara në vend dhe të tregtuara jashtë vendit për një periudhë të dhënë kohe (tremujore).

#### **Indeksi i çmimeve të importit**

Indeksi i çmimeve të importit mat ndryshimin në çmimet e importit. Import është çdo lloj produkti që nuk është prodhuar në Shqipëri, por që është importuar nga një vend tjetër.

#### **Numri mesatar i të punësuarve gjithsej**

Indeksi i numrit mesatar të personave të punësuar gjithsej ka si objektiv të tregojë zhvillimin e punësimit. Numri mesatar i të punësuarve gjithsej është përkufizuar si numri total i personave që punojnë në njësinë e vëzhguar (duke përfshirë pronarët që punojnë, partnerë që punojnë rregullisht në njësi dhe pjestarët e familjes që punojnë, por nuk paguhen), si dhe i personave që punojnë jashtë njësisë, por që i përkasin asaj dhe që paguhen nga ajo (psh. përfaqësuesit e shitjeve, personeli i shpërndarjes, skuadra e riparimit dhe e mirëmbajtjes).

#### **Numri mesatar i të punësuarve me pagesë**

Janë të gjithë personat që punojnë për llogari të punëdhënësit kundrejt një page për punën që kryejnë.

#### **Fondi pagave**

Indeksi i fondit të pagave ka për objektiv të tregojë ecurinë e kostove gjithsej të personelit. Pagat janë përkufizuar si shpërblimi total në monedhë ose në natyrë, të paguar të gjithë personave të shënuar në listën e pagave (duke përfshirë dhe ato që punojnë në shtëpi) si shpërblim i punës së bërë gjatë periudhës së llogaritur pavarësisht nëse është paguar në bazë të kohës së punës, prodhimit apo punës me pjesë dhe nëse është paguar rregullisht ose jo).

#### **Indeksi i Kushtimit në Ndërtim**

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, fuqisë punëtore dhe shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate).

**Indeksi i Kostos së materialeve** mat ecurinë e çmimeve të materialeve kryesore në ndërtimit. Ky grup është i ndarë në tre nëngrupe: materiale ndërtimi, materiale elektrike dhe komunikimi dhe materiale hidrosanitare.

**Indeksi “Shpenzime page”** mat ecurinë e pagave për inxhinierët, teknikët dhe punëtorët e thjeshtë.

#### **Treguesit kryesor të lejeve të ndërtimit janë:**

Numri gjithsej i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente)

Sipërfaqja gjithsej në metra katrorë e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente) Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente) dhe punime inxhinierike Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente) dhe punime inxhinierike sipas klientit

#### ***Lejet e ndërtimit: Numri i ndërtesave, Metra katrorë të sipërfaqes gjithsej***

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës

Lejet e ndërtimit të miratuara parashikojnë ecurinë e sektorit të ndërtimit për periudhën pasardhëse bazuar në të dhënat kryesore të përfuara nga ky tregues Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve,

	kafshëve ose objekteve Sipërfaqja në metra katrorë është hapësira gjithsej ku vihet në zbatim projekti i miratuar.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Popullsia statistikore përfshin njësitë statistikore, ndërmarrjet aktive në periudhën referuese, të cilat operojnë në aktivitetet ekonomike sipas NVE Rev.2, Industri (seksionet B, C,D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39); Ndërtim (seksioni F, ndarjet 41-43); Tregti (seksioni G, ndarjet 45-47); Shërbime (seksioni H, ndarjet 49-53; seksioni I, ndarja 55.1 dhe 56; seksioni J, ndarjet 58-63; seksioni M, ndarja 71; seksioni N, ndarja 79).
3.7. Zona e referencës	Statistikat Afatshkurtra mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat afatshkurtra tremujore referuar indekseve të shitjeve, prodhimit, numrit të punësuarve, fondit të pagave datojnë prej vitit 2005 në vazhdim. Indeksi i shitjeve dhe volumit në Tregtinë me Pakicë dhe Indekset e Çmimeve të Prodhimit datojnë prej vitit 1999 në vazhdim. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim daton prej vitit 1993 në vazhdim. Indekset e Çmimeve të Importit janë publikuar për herë të parë në 2016 me seri kohore 2012-2016 (2012=100).
3.9. Periudha bazë	Viti bazë: 2015 = 100, aplikohet duke filluar nga tremujori i parë 2019.
4. Njësia matëse	Njësitë matëse janë Indekset dhe Ndryshimet në përqindje.
5. Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar nga SASH i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2022.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore në të cilin bazohen indikatorët e statistikave afatshkurtra konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026</a></li> </ul> <p>Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja e Këshillit Nr.1165 / 98</a> duke prezantuar Statistikat afatshkurtra në nivel Evropian</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit Nr.1503 / 2006</a> e cila përcakton variablat dhe shpeshësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe urdhërat e reja të marra për inxhinierinë civile.</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nga tremujori i parë 2018 statistikat afatshkurtra transmetohen rregullisht në Eurostat për disa tregues kryesorë.

<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloren, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendari i publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	<p><a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>



8.3. Aksesi i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Të dhënat e SASH shpërndahen me bazë tremujore.
<b>10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afatshkurtra. Formati i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Rezultatet e Statistikat Afatshkurtra gjenden të botuara në publikimin e dedikuar dhe në Vjetarin Statistikor. Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Industria, Tregtia dhe Shërbimet, Statistikat afatshkurtra (publikim i dedikuar)</a></li> <li>• <a href="#">Vjetari Rajonal Statistikor</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">Databaza Statistikore</a>
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat e SASH në nivel mikro nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe

	publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlllogaritjen e indeksit dhe i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare.  Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e SASH-së janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm.  Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministritë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale.</li> <li>• Universitetet (profesorë / studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore.</li> <li>• OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare</li> <li>• Ndërmarrjet</li> <li>• Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave masive përmes publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave.</li> </ul> Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare</li> <li>• Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Statistikat Afatshkurtra për vitin 2022 janë rreth 24,020 klikime.</p> <p>Gjatë 2022 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave Afatshkurtra është vlerësuar me 3.31 (66.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Për sa i përket plotshmërisë së Statistikave Afatshkurtra, ajo ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për vrojtimin e Statistikave Afatshkurtra për vitin 2022 është 70.6%. Kjo llogaritje bazohet duke marrë parasysh raportin e kërkesave të përmbushura nga INSTAT me atë që kërkohet nga rregulloret evropiane.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p> <p>Popullata e vëzhguar e Statistikave Afatshkurtra 2022 përfshin afërsisht 12.000 ndërmarrje për çdo tremujor. Dizanji i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i punonjësve sipas NVE Rev.2 në nivel 3 shifror.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njësive outlier kryhet rregullisht. Shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë keq klasifikimi i njësive dhe ndryshimet në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjesh vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrojtimit llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim. <b>Devijimi standart relativ (CV)</b> mesatarisht për variablin Shitje Neto është 0.66%.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në</p>

	<p>gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. <b>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi</b> mesatarisht për SASH 2022 është 2.94%.</p> <p><b>Shkalla e Mos-përgjigjes në nivel variabli</b> mesatarisht për variablat kryesor të SASH është: për Numrin e të punësuarve gjithsej është 0.99%, ndërsa për Shitjet neto është 1.06%.</p>
--	--

#### 14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	<p>Indekset e Statistikave Afatshkurtra janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 75 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+75 ditë). Periudha referuese e rezultateve është 31 Dhjetori 2022.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/16/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>75</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	3/16/2023	Afatet kohore	75		
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e publikimit	3/16/2023								
Afatet kohore	75								
14.2. Përpikmëria	<p>Indekset e Statistikave Afatshkurtra publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave Afatshkurtra ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/16/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/16/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	3/16/2023	Data e publikimit	3/16/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	3/16/2023								
Data e publikimit	3/16/2022								
Vonesa në kohë	0								

#### 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat mbi treguesit e SASH janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithë përfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.</p>
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve në SASH ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. ATN ka filluar për herë të parë në vitin 2003. Në vitin 2005 është shtuar aktiviteti i Tregtisë me shumicë. Në vitin 2008 metoda e kampionimit kalon nga metoda me listim në metodën e kombinuar (me kampionim dhe listim). Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia e ATN si rezultat i përditësimit të Rregjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Në vitin 2014 në SASH implementohet Nomenklatura e Re e Aktiviteteve Ekonomike, NVE REv.2, përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2005 në 2010.</p> <p>Në vitin 2019 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2010 në 2015. Në të gjitha këto ndryshime seritë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë përditësuar për të reflektuar ndryshimet. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në Shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse.</p> <p>Të dhënat e Statistikave afatshkurtra sipas tremujorëve bazuar në Klasifikimin e</p>

	<p>Aktivitetit Ekonomik NVE Rev 2, datojnë që nga viti 2006 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 17 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=17).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Indeksi i shitjeve neto në shërbime është vlerësuar duke përdorur të dhënat e TVSH. Për ndërmarrjet që të dhënat e TVSH nuk janë të disponueshme është përdorur vrojtim me zgjedhje. Nuk ekziston informacion tjetër statistikor i cili mund të përdoren për kontrollin e koherencës.</p>
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikor.</p>
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Specialistë në zyrat qendrore 8 të punësuar;</li> <li>2. Specialistë logjistike 2 të punësuar;</li> <li>3. Anketues 150 të punësuar;</li> <li>4. Kontrollorë 9 të punësuar;</li> <li>5. Operatorë 9 të punësuar.</li> </ol> <p>Anketuesit punësohen katër herë në vit për anketat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve;</li> <li>• Anketa e Çmimeve të Prodhimit;</li> <li>• Anketa e Çmimeve të Importit;</li> <li>• Anketa e Kostos së Ndërtimit.</li> </ul> <p>Transmetimi i të dhënave administrative mundësohet pa kosto përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkuara midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).</p> <p>Burimet Statistikore si (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brëndshëm. Stafi i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të ATN bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul> <p>E njëjta politikë revizionimi është aplikuar në publikimet në nivel kombëtar dhe</p>

	transmetimin në Eurostat.
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikave Afatshkurtra” për vitin 2022. Nuk ka vlerësime numerike të indikatorëve MR dhe MAR.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Të dhënat mbi Statistikat Afatshkurtra bazohen në anketat statistikore tremujore dhe të dhënat administrative. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kritere themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përzgjedhjes së përdorur është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afatshkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mblidhen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Gjatë vitit 2022, të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit pranë ndërmarrjeve.. Kohëzgjatja e intervistimit të drejtpërdrejtë ishte 15 ditë pas tremujorit referues dhe u krye vetëm për ndërmarrjet të cilat nuk ishin subjekt i deklaramit në burimet administrative.</p> <p>Gjatë vitit referencë nuk është planifikuar ndryshim në pyetësor.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i TVSH-së vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme. Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifkohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet. Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrollë për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherent. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave.</p>



	<p>Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjen e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njesi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të agregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p><b>Nivel Kombëtar</b></p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit direkt i mbledhur nga anketuesit. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i plotshmërisë së pyetsorëve</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetsorëve (kontrolli i shënimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimit të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave)</li> <li>• Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit).</li> <li>• Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit për ndërmarrjet e rëndësishme (ndërmarrjet e mëdha) duhet të plotësohen nëpërmjet proçesit të imputimit duke përdorur informacionin e marrë nga burime të tjera.</li> <li>• Krahasueshmëria e të dhënave (ndërmjet të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative, periudhat e mëparshme ose trendet).</li> <li>• Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein).</li> <li>• Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit</li> <li>• Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera</li> <li>• Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et).</li> </ul> <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>
<p>18.6. Rregullimi</p>	<p>Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të treguesve të statistikave afatshkurtra u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1.0. Modeli i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.</p>
<p>19. Komente</p>	
<p><b>Aneks</b></p>	